

 <p>Liberté • Égalité • Fraternité RÉPUBLIQUE FRANÇAISE MINISTÈRE DE LA JUSTICE</p>	<p style="text-align: center;">NJOFTIM MBI TE DREJTAT Dorezuar nje personi te degjuar ne gjendje te lire (Formular i pergjithshem)</p>
--	---

Informacionet e meposhteme duhet t'ju jepen ne nje gjuhe qe e kuptoni.

Njoftoheni se po degjoheni pasi egziston kunder jush nje apo disa aresye te mundshme per te dyshuar se keni kryer apo tentuar te kryeni nje veper.

Keni te drejte te njihni kualifikimin juridik, daten dhe vendin e dyshuar te kryerjes se vepres per te cilen po degjoheni.

Keni te drejte te largoheni ne çdo moment nga ambjentet ku po degjoheni.

PERVEC KESAJ, NJOFTOHENI SE KENI TE DREJTE :

Te beni deklarata, t'i pergjigjeni pyetjeve ose te heshtni.

Pasi te keni dhene identitetin tuaj, keni te drejte, gjate degjimit :

- te beni deklarata,
- t'i pergjigjeni pyetjeve qe ju behen,
- ose te heshtni.

Te asistoheni nga nje avokat

Nese vepra per te cilen po degjoheni eshte nje krim apo nje delikt i ndeshkuar me denim burgimi, ju mund te asistoheni gjate degjimit ose ballafaqimit tuaj.

- Zgjedhja e avokatit

Ju mund te kerkoni te asistoheni nga nje avokat qe e zgjidhni vete. Nese nuk jeni ne gjendje te caktoni nje avokat ose nese avokati i zgjedhur nuk mund te kontaktohet, mund te kerkoni qe t'ju caktohet nje avokat nga kryetari i dhomes se avokatisë.

Shpenzimet jane ne ngarkimin tuaj pervec rastit kur plotesoni kushtet e perfitimit nga ndihma juridike, te cilat figurojne ne dokumentin shtese, qe ju eshte dorezuar.

- Asistenca e avokatit

Avokati mund :

- te bisedoje me ju ne kushte qe garantojne konfidencen e bisedes;
- dhe te asistojë gjate degjimeve dhe ballafaqimeve tuaja.

Ju mund te pranoni te vazhdoni degjimin tuaj jashte pranise se avokatit tuaj.

Te asistoheni nga nje perkthyes

Nese nuk flisni apo nuk kuptoni frengjisht , keni te drejte te asistoheni falas nga nje perkthyes gjate degjimeve e ballafaqimeve tuaja dhe per te komunikuar me avokatin tuaj.

Te konsultoni disa nga elementet e dosjes suaj

Me kerkesen tuaj apo te avokatit tuaj, ju mund te kerkoni te konsultoni proces-verbalin apo proces-verbalet e degjimeve dhe ballafaqimeve tuaja.

Te perfitoni nga keshilla juridike

Ju keni mundesine te perfitoni, ne rast nevoje falas, nga keshilla juridike ne nje strukture ndihme juridike, koordinatat e se ciles ju komunikohen ne nje dokument shtese.